

Titulli i lëndës:	Fizika e Ndërtimit dhe Performanca Energjetike
Përshkrimi i lëndës:	Hyrje në Fizikën e ndërtimit si fushë, dhe në performansën energjetike të ndërtesës duke përfshirë aspektet termike dhe vizuale të performansës së ndërtesës. Në këtë kontekst hyjnë: aspektet kryesore të performansës energjetike të ndërtesës, fizika termike; transferimi i nxehtësisë dhe masës, komforti termik, pikëvështrim i performansës vizuale të ndërtesës, etj.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon në ofrimin e një hyrjeje dhe pikëpamje në fushën e gjerë të fizikës së ndërtesave në arkitekturë (kushtet termike, akustike dhe vizuale të hapësirave të brendshme).
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Ky kurs synon në ofrimin e një hyrjeje në fushën e fizikës së ndërtimit (teorisë dhe praktikës) si dhe aspekteve kryesore të performancës së ndërtesës sa i përket energjisë.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë i aftë të: (1) të ketë një pikëpamje të gjerë për fushën e fizikës së ndërtimit dhe performancës energjetike të ndërtesës; (2) analizojë performansën energjetike (termike, akustike dhe vizuale) të ndërtesës; (3) aplikojë njohuritë për fizikën e ndërtimit dhe performansës së energjisë së ndërtesës drejt një arkitekture dhe ndërtimi me efikasitet të energjisë dhe ambientaliste.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimin duke përdorë materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentëve në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentëve 10%, Puna hulumtuese (shkrimi dhe prezantimi) 15+15=30%, Puna seminarike (projekti dhe prezantimi) 15+15=30%, dhe Provimi përfundimtar (2 teste teorike) 15+15=30%. Studentët kanë të drejtë të vlerësohen në provim përfundimtar vetëm nëse kanë përfunduar me sukses punën hulumtuese dhe seminarike.
Literatura primare:	Szokolay, S. Introduction to Architectural Science. Architectural Press (Elsevier), Second Edition, 2008. Hens, H. Building Physics – Heat Air Moisture. Ernst&Sohn, Berlin, 2007. Hens, H. Applied Building Physics. Ernst&Sohn, Berlin, 2011.